



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr.1035/1 Prot.

Tiranë, më 09.06 .2026

**V E N D I M**

**Nr.159, Datë 09.06. 2026**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr.132 Regj., datë 02.06.2026, të z. N.B , kundër Bashkisë Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesi N.B , parashtron se është person me aftësi të kufizuara në shikim. Ai deklaron se, më datë 21.05.2024, së bashku me shoqëruesin e tij, ka udhëtuar me autobus urban në qytetin e Shkodrës. Gjatë udhëtimit, faktorinoja i është afruar për të marrë pagesën. Në atë moment ankuesi deklaron se i ka paraqitur librezën e invaliditetit, me qëllim që të përfitonte të drejtën që i njihet nga legjislacioni në fuqi si person i verbër.

Ankuesi deklaron se, pavarësisht paraqitjes së dokumentacionit përkatës, faktorinoja refuzoi të njohë statusin e tij dhe këmbënguli që të kryente pagesën e plotë të biletës, por pavarësisht sqarimeve faktorinoja vazhdoi t’i kërkonte pagesën e plotë pa marrë në konsideratë dokumentacionin e paraqitur. Situata u tensionua dhe debati verbal u përshkallëzua, deri në një konfrontim fizik.

Ankuesi pretendon se si pasojë e kësaj ngjarje është ndjerë i diskriminuar dhe i cenuar në dinjitetin e tij, pasi e konsideron se mosnjohja e të drejtave që lidhen me aftësinë e tij të kufizuar, si dhe mënyra si u trajtua gjatë incidentit, përbëjnë trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave përkatëse për të garantuar respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në transportin publik.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preference, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozonë ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

- Referuar informacionit të parashtruar në ankesë dhe akteve bashkëlidhur, rezulton se:

Ankuesi z. N.B është person me aftësi të kufizuara në shikim. Ngjarja e pretenduar si sjellje diskriminuese ka ndodhur më datë 21.05.2024, datë në të cilën ankuesi pretendon se i është refuzuar njohja e të drejtave si person me aftësi të kufizuara gjatë udhëtimit me autobus urban në Shkodër. Ankuesi e citon këtë datë si momentin e ndodhjes së sjelljes diskriminuese të pretenduar.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankesa nuk pranohet kur: .... dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”.* Kushtet e parashikuara nga dispozita e sipërcituar nuk janë kumulative dhe rrjedhimisht, plotësimi i njërit prej tyre sjell si pasojë mospranimin e ankesës.

Nga shqyrtimi i ankesës rezulton se ngjarja e pretenduar si diskriminuese ka ndodhur më datë 21.05.2024, e pohuar si e tillë nga vetë ankuesi. Duke qenë se ankuesi ishte i pranishëm gjatë ndodhjes së ngjarjes, ai ka marrë dijani për sjelljen e pretenduar diskriminuese në të njëjtën datë, pra më 21.05.2024. Ankesa pranë Komisionerit është depozituar më datë 02.06.2026.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar dhe momenti i marrjes dijeni për këtë sjellje të pretenduar diskriminuese është i njëjtë, pra data 21.05.2024.

Rrjedhimisht, nga data e marrjes dijeni për sjelljen e pretenduar diskriminuese (21.05.2024) deri në datën e depozitimit të ankesës pranë Komisionerit (02.06.2026) kanë kaluar më shumë se 2 (dy) vjet.

Në këto rrethana, Komisioneri konstaton se afati ligjor i parashikuar nga neni 33, pika 4, gërma “dh”, i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është tejkaluar, duke qenë se ankesa është depozituar pas kalimit të afatit prej 2 (dy) vjetësh nga data e marrjes dijeni për sjelljen e pretenduar diskriminuese. Në këto kushte, ankesa nuk mund të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme të shqyrtimit nga ana e Komisionerit<sup>3</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 132 Regj., datë 02.06.2026, të paraqitur nga z. N.B , në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi ankesa është paraqitur në tejkallim të afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

Shkaku: Aftësia e kufizuar  
Fusha: Shërbime  
Lloji i vendimit: Mospranim jashtë afateve

---

<sup>3</sup> Për analogji vendimet: nr. 167, datë 23.08.2023, nr. 158, datë 28.05.2024 dhe nr. 55, datë 12.03.2025, të Komisionerit.